




Shqip

ŠKOFJA LOKA, VENDI IM I RI

Mirë është ta dini: **Broshurë me informacione për të ardhurit**

Përshëndetje,

shpërngulja dhe kërkimi i një banese të re janë gjithmonë sfiduese. Ndërtimi i jetës në një rreth të ri dhe integrimi në mënyrë të plotë bëhet i mundur edhe duke u bërë pjesë e komunitetit. Shkofja Lloka është një komunitet i gjallë, ekonomikisht i suksesshëm dhe kulturorisht i pasur, që i mundëson secilit individ të realizojë potencialet e veta. Arsimi cilësor, institucionet e shumta publike dhe një gamë e gjerë aktivitetesh janë garanci për një jetë me cilësi të lartë. Pikërisht këtij qëllimi i shërben edhe ky udhëzues për shërbimet që ofrojnë institucionet publike dhe organizatat e tjera në qytetin tonë mijërvjeçar.

Tine Radinja, kryetar i komunës

Ndërmjetësimi kulturor për gjuhën shqipe

Komuna e Shkofja Llokës financon projektin e ndërmjetësimit kulturor. Në kopsht, shkollën fillore, qendrën shëndetësore, qendrën për punë sociale dhe në Njësinë administrative mund të merrni ndihmën e një ndërmjetësuesje kulturore, e cila ju siguron përkthim nga sllovenishtja në shqip dhe anasjelltas, si edhe shpjegime në gjuhën shqipe.

Për shërbimin e ndërmjetësimit kulturor mund të kërkoni ndihmë gjatë caktimit të kontrollit mjekësor, gjatë njoftimit për takime me prindër ose mbledhje në kopsht, shkollë etj. Institucioni kujdeset që gjatë vizitës suaj (në shkollë, qendrën shëndetësore etj.) ndërmjetësuesja kulturore të jetë e pranishme.

Ky shërbim është i dedikuar kryesisht për ata që janë shpërngulur në Shkofja Llokë gjatë 2 viteve të fundit.

KOMUNA E SHKOFJA LLOKËS

Komuna e Shkofja Llokës ndodhet në kalimin nga kodrat paraalpine të rajoneve Shkofje Llokes dhe Polhov Gradecit drejt pellgut të Lubljanës. Qyteti shtrihet në pikën ku bashkohen lugina e Sellskës dhe ajo e Poljanskës me fushën e Sorës. Ky territor gjatë gjithë historisë së tij ka qenë një zonë me rëndësi të madhe kalimtare për komunikacionin.

Edhe sot ruan një pozitë të favorshme trafiku: ndodhet 26 kilometra larg Lubljanës dhe 20 km nga Aeroporti i Lubljanës. Jo larg qytetit kalon edhe linja hekurudhore Ljubljana–Jesenice.

Qyteti për më shumë se 800 vjet ka qenë qendër administrative, ekonomike dhe kulturore e zotërimit feudal, të cilin në vitin 973 perandori gjerman Otoni II ia dhuroi dioqezës së Freisingut nga Bavaria.

Sipërfaqja e Komunës së tanishme të Shkofja Llokës është 146 km², ndërsa në territorin e saj jetojnë rreth 23.000 banorë. Shkofja Lloka është qendër rajonale, e cila ka disa institucione administrative, si dhe veprimtari shoqërore publike dhe shërbyese me rëndësi më të gjerë. Ajo renditet ndër qendrat më të rëndësishme ekonomike me veprimtari industriale të mirë zhvilluar.

Çfarë mund të rregulloj në Njësine administrative?

Në Njësine administrative rregulloni gjithçka që lidhet me lejet e qëndrimit, regjistrimin e vendbanimit të përkohshëm ose të përhershëm, lejen unike për punë dhe qëndrim, lidhjen e martesës, lëshimin e certifikatës së lindjes dhe shumë çështje të tjera, si patent shoferët, dokumentet e humbura etj.

Për leje qëndrimi të përkohshëm mund të aplikoni vetëm nëse keni hyrë ligjërisht në Slloveni dhe i plotësoni kushtet e tjera, për shembull studioni ose punoni këtu. Për lejen e parë, si rregull, duhet të aplikoni në përfaqësinë e Republikës së Sllovenisë jashtë vendit. Sipas rregullave të reja, nëse keni hyrë ligjërisht në Slloveni, mund të aplikoni në cilëndo njësi administrative në Republikën e Sllovenisë dhe të dorëzoni edhe gjurmët e gishtërinjve dhe nënshkrimin në tabletë. Vazhdimin e lejes mund ta rregulloni në cilëndo njësi administrative në Slloveni. Nëse shpërnguleni, duhet që brenda 8 ditëve në Njësine administrative të rregulloni regjistrimin e vendbanimit të përkohshëm. Nëse nuk kuptoni dhe nuk flisni mirë sllovenisht, duhet të siguroni edhe një përkthyes, i cili do t'ju ndihmojë gjatë kryerjes së shërbimeve të dëshiruara në Njësine Administrative.

Leja e qëndrimit për fëmijën që ka lindur në Slloveni lëshohet sipas detyrës zyrtare. Prindërit duhet brenda 3 muajve të dorëzojnë kërkesë në Njësine administrative dhe të paraqesin fotografinë dhe certifikatën e lindjes së fëmijës. Vetëm kur fëmija posedon leje qëndrimi, ai ka të drejtë për sigurim shëndetësor.

Mësimi i gjuhës sllovene dhe njohja e shoqërisë sllovene zhvillohet si program i unifikuar me emrin Integrimi fillestar i të huajve –ZIP (IFH). Programi përfshin disa fusha të ndryshme përmbajtjesore, përmes të cilave pjesëmarrësi aftësohet për komunikim në rrethin e ri dhe fiton njohuri për kryerjen e provimit të gjuhës sllovene “Sllovenishtja si gjuhë e dytë dhe e huaj”, sidomos në nivelin hyrës dhe fillestarë A1, A2/B1.

Të drejtë për të ndjekur programin ZIP kanë të huajt, shtetas të vendeve të treta, të cilët:

- banojnë në Republikën e Sllovenisë në bazë të lejes së qëndrimit të përkohshëm, të lëshuar me vlefshmëri të paktën një vit;
- janë anëtarë të familjes së shtetasve sllovenë ose të shtetasve të BE-së, që banojnë në Republikën e Sllovenisë në bazë të lejes së qëndrimit për anëtar familjeje, pavarësisht kohëzgjatjes së qëndrimit dhe vlefshmërisë së lejes së qëndrimit të përkohshëm;
- banojnë në Republikën e Sllovenisë në bazë të mbrojtjes së përkohshme të njohur, në përputhje me ligjin që rregullon mbrojtjen e përkohshme të personave të zhvendosur.

Nëse dëshironi të ndiqni programin ZIP, duhet të merrni një vërtetimin në Njësine administrative, me të cilin dëshmoni që plotësoni kushtet për pjesëmarrje në programin e unifikuar.

Për zgjatjen e lejes së qëndrimit të përkohshëm për shkak të bashkimit familjar ju nevojitet provimi i kryer i gjuhës sllovene në nivel mbijetese. Nëse dëshironi të ndiqni programin joformal të mësimi të gjuhës sllovene në nivel mbijetese, duhet të merrni në Njësine administrative vërtetimin për plotësimin e kushteve për pjesëmarrje në programin joformal.

Më shumë për kurset ZIP dhe programin joformal të mësimi të gjuhës sllovene në nivel mbijetese: www.infotujci.si/vkljucevanje-v-slovensko-druzbo/brezplacni-tecaji-slovenskega-jezika.

Për dorëzimin e kërkesës në Njësine administrative dhe lëshimin e vërtetimit duhet të paguani taksën administrative në vlerë prej 22,60 EUR.

Nëse dëshironi të shmangni radhë të pritjes, mund të rezervoni termin në Njësine Administrative përmes aplikacionit online **eSamonaročanje**. Të gjitha informacionet i gjeni në portalin www.gov.si.

Shumë çështje administrative mund t'i rregulloni edhe përmes portalit **e-uprava** në e-uprava.gov.si/en.

Upravna enota Škofja Loka
Njësia Administrative Škofja Loka
Poljanska cesta 2, 4220 Škofja Loka
ue.skofjaloka@gov.si
+386 4 555 01 00

Si mund t'ju ndihmojë Qendra për punë sociale?

Mund t'i drejtoheni sa herë që gjendeni në vështirësi ose probleme. Punonjësit ekspert do t'ju ndihmojnë. Aty mund t'ju ofrojnë ndihmë financiare, si edhe ndihmë për përfshirje në komunitet, ndihmë për familjet dhe fëmijët si dhe këshillime të ndryshme.

Ndihma e parë sociale nënkupton bisedën e parë me një punonjës ekspert, ku do të flisni për vështirësitë tuaja dhe së bashku do të kërkonit zgjidhje. Do të merrni informacione për format e ndihmës që janë në dispozicionin tuaj dhe si mund ta merrni atë ndihmë, përfshirë ndihmën financiare dhe ndihmën që ofrojnë organizata të tjera, si Kryqi i Kuq, Karitasi etj.

Si të merrni ndihmën e parë sociale?

Në bisedën e parë me punonjësen ekspert mund të vini gjatë orarit zyrtar. Nuk është e nevojshme të caktoni termin paraprakisht. Në raste urgjente mund t'ju ndihmojnë edhe jashtë orarit zyrtar, por gjatë kohës kur qendra është e hapur.

Ndihma personale nënkupton këshillim individual afatgjatë për zgjidhjen e problemeve tuaja, si edhe rregullim dhe udhëheqje. Ajo varet nga nevojat tuaja, ndërsa kusht është bashkëpunimi vullnetar dhe aktiv. Punonjësi ekspert së bashku me ju do të përgatisë një plan për zgjidhjen e problemit, do t'ju udhëzojë gjatë rrugës së zgjidhjes së vështirësive dhe rregullimit të jetës.

Ndihma për familjen në shtëpi nënkupton ndihmë në rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të familjes dhe kujdesin për fëmijët. Për nga përmbajtja është e ngjashme me ndihmën personale, vetëm se në këtë rast në këshillim përfshihen më shumë anëtarë të familjes.

Ndihma financiare: ju mund të aplikoni për shtesa të fëmijëve, ndihmë sociale në para, shtesa mbrojtëse, ulje të pagesës për kopshtin, subvencion për ushqim për nxënës dhe gjimnazistë, subvencion për qira, lirimin nga pagesa e kontributit për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor dhe/ose shërbime të mbrojtjes sociale dhe të ngjashme.

Më shumë për të drejtat e veçanta mund të lexoni edhe në faqen: www.csd-slovenije.si.

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor kryhet nga Enti për Sigurim Shëndetësor i Sllovenisë, ZZZS, sipas parimeve të drejtësisë sociale dhe solidaritetit ndërmjet të shëndetshëmëve dhe të sëmurëve, të moshuarve dhe të rinjve, të pasurve dhe të varfërve. Sigurimi shëndetësor në Republikën e Sllovenisë është i detyrueshëm për të gjithë personat që plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen shëndetësore dhe sigurimin shëndetësor, ZZVZZ. Sipas ZZVZZ-së, persona të siguruar janë të siguruarit dhe anëtarët e familjes së tyre.

Për të siguruarit, ZZVZZ përcakton detyrimin e pagesës së kontributeve, duke përcaktuar edhe kush është i detyruar t'i paguajë ato dhe kush është i detyruar ta regjistrojë personin në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, llojin e kontributeve, bazën nga e cila paguhet ato, si edhe fushën e të drejtave.

Pagesa e kontributeve të përcaktuara lidhet me burimin që i siguron të siguruarit sigurinë bazë sociale, si punësimi, pensioni, veprimtaria e pavarur, invaliditeti, mjetet vetjake, ndihmat shoqërore.

Në rast se shtetasi slloven me vendbanim të përhershëm në Republikën e Sllovenisë nuk i plotëson kushtet për të qenë i siguruar sipas ndonjëres prej pikave të përcaktuara të nenit 15 të ZZVZZ-së, atë në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor e regjistron Qendra kompetente për punë sociale, e cila gjithashtu vërteton plotësimin e kriterëve që personi duhet të përmbushë. Anëtarët e familjes përfshihen në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor përmes të siguruarve si bartës të sigurimit, nëse nuk i plotësojnë kushtet për të qenë vetë të siguruar.

Regjistrimin, ndryshimin ose çregjistrimin e personave në ose nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor e kryen, në bazë të kërkesës së personit përgjegjës për regjistrim, njësia rajonale ose zyra e ZZZS-së.

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor u mundëson personave të siguruar realizimin e të drejtave për shërbime shëndetësore, barna, pajisje mjekësore dhe kompensime në para, si kompensimi i pagës gjatë mungesës së përkohshme nga puna dhe rimbursimi i shpenzimeve të udhëtimit në lidhje me realizimin e të drejtave për shërbime shëndetësore.

Center za socialno delo Gorenjska, Enota Škofja Loka
Qendra për punë sociale Gorenjska, Njësia Škofja Loka

Partizanska 1d, 4220 Škofja Loka

www.csd-skofjaloka.si

gpcsd.skofj@gov.si

+386 4 51 70 100

Kontributi i detyrueshëm shëndetësor

Sigurimi shëndetësor plotësues u shfuqizua më 31. 12. 2023 dhe nga janari 2024 u vendos kontributi i ri i detyrueshëm shëndetësor (OZP), i cili së bashku me kontributet ekzistuese për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor siguron financimin 100% të të drejtave nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor.

Të gjitha informacionet në lidhje me sigurimin e detyrueshëm shëndetësor dhe kontributin e detyrueshëm shëndetësor mund t'i gjeni në faqen www.zzzs.si.

ZZZS OE Kranj, Izpostava Škofja Loka
Enti për Sigurim Shëndetësor i Sllovenisë
Njësia Rajonale Kranj
Zyra Škofja Loka

Stara cesta 12, 4220 Škofja Loka

www.zzzs.si

oekr@zzzs.si

+386 4 502 33 00



Kur e keni rregulluar sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, duhet të zgjidhni mjekun personal, të cilin e vizitoni sa herë që keni probleme shëndetësore. Listën e mjekëve të lirë mund ta gjeni në faqet e ZZZS-së, te rubrika shërbimet shëndetësore, zgjedhja e mjekut personal. Në qendrën shëndetësore funksionon edhe dispanseri për fëmijë dhe nxënës, ku përveç shërbimeve shëndetësore do t'ju ofrohet edhe këshillim për fëmijën ose nxënësin tuaj.

Përveç mjekut personal të mjekësisë familjare, zgjidhni edhe stomatologun personal dhe gjinekologun.

Në qendrat shëndetësore funksionon edhe këshillimorja, ku mund të merrni informacione për ruajtjen e shëndetit, ushqimin e shëndetshëm, lëvizjen e rregullt, ruajtjen e peshës optimale, jetën pa vese të dëmshme, si duhani dhe alkooli, mbajtjen e marrëdhënieve të mira ndërpersonale dhe menaxhimin e stresit. Të gjitha këshillimet dhe punëtoritë janë falas dhe të hapura për të gjithë ata që dëshirojnë të bëjnë diçka për shëndetin e tyre. Për hollësi pyesni në qendrën më të afërt shëndetësore.

Në qendrat për shëndetin mendor të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve sigurojmë trajtim të plotë për personat me vështirësi në fushën e shëndetit mendor. Për trajtim mund të caktoni termin edhe pa udhëzim mjekësor. Për hollësi pyesni në qendrën më të afërt shëndetësore.

Për ndihmë urgjente mjekësore telefononi në numrin falas 112 ose vizitoni ambulancën urgjente, e cila funksionon 24 orë.

Për komunikim mund të përdorni doracakë shumëgjuhësh për komunikim në shëndetësi, të cilët gjenden në faqen Multilingual health (<http://multilingualhealth.ff.uni-lj.si>).

Zdravstveni dom Škofja Loka
Qendra Shëndetësore Škofja Loka

Stara cesta 10, 4220 Škofja Loka

www.zd-loka.si

info@zd-loka.si

+386 4 502 00 00



KOPSHTI

Kopshti Škofja Loka funksionon në 10 njësi dhe në 11 lokacione të ndryshme.

- **Njësia BIBA:** Podlubnik 1e, Škofja Loka;
- **Njësia BUKOVICA:** Bukovica 34, 4227 Selca;
- **Njësia CICIBAN:** Sveti Duh 11, Škofja Loka;
- **Njësia KAMNITNIK:** Partizanska 1e, Škofja Loka;
- **Njësia NAJDIHOJCA:** Podlubnik 1d, Škofja Loka;
- **Njësia ROŽLE:** Frankovo naselje 61, Škofja Loka;
- **Njësia PEDENJPED:** Frankovo naselje 51a, Škofja Loka;
- **Seksioni në Reteče:** Reteče 43, Škofja Loka;
- **Njësia POD GRADOM:** Kapucinski trg 2, Škofja Loka;
- **Njësia KAMENČEK:** Partizanska cesta 1c, Škofja Loka;

Në kopsht mund të përfshihen fëmijët nga mosha 11 muajshe, përkatësisht nga përfundimi i pushimit të lehonisë, deri në hyrjen në shkollë. Rekomandohet që fëmijët të qëndrojnë në kopsht më së shumti 9 orë. Grupet në kopsht janë kryesisht homogjene, që do të thotë se në to përfshihen fëmijë të lindur brenda të njëjtit vit. Programin edukativo-arsimor në grup e zbatojnë edukatori/ja dhe ndihmësi/ja i/e edukatorit/es.

REGJISTRIMI NË KOPSHT

Për regjistrim në kopsht duhet të plotësohet formulari i regjistrimit, i cili është i disponueshëm në faqen e internetit të kopshtit. Formulari mund të dorëzohet personalisht në administratën e kopshtit, (njësia Kamnitnik, Partizanska cesta 1e, 4220 Škofja Loka), të dërgohet me postë ose në adresën elektronike vpis@vrtec-skofjaloka.si. Një herë në vit, në fillim të marsit, në kopsht zhvillohet afati i rregullt i regjistrimit dhe formularët e dorëzuar atëherë kanë përparësi për pranimin me vitin e ri shkollor, përkatësisht nga 1 shtatori. Formularin mund ta dorëzoni edhe në çdo kohë gjatë vitit shkollor, por përfshirja është e mundur vetëm nëse ka vende të lira.

VËRTETIMI MJEKËSOR

Për përfshirje në kopsht nevojitet edhe **vërtetimi mjekësor**, të cilin e plotëson mjeku personal i fëmijës, pediatri që punon në Slloveni. Nga vërtetimi duhet të jetë e qartë se fëmija është i vaksinuar kundër fruthit, shytave dhe rubeolës. Vërtetimi mjekësor **duhet të dorëzohet më së voni ditën e përfshirjes në kopsht**.

Nëse fëmija ka dietë, në kopsht duhet të sillni vërtetim për dietë të indikuar mjekësisht, të cilin e plotëson pediatri i fëmijës.

PAGESA E ULUR E KOPSHTIT

- Kërkesa për realizimin e të drejtave nga fondet publike, përkatësisht pagesën e ulur të kopshtit, duhet të dorëzohet në Qendrën për Punë Sociale për secilin fëmijë që përfshihet në kopsht.
- Kopshti është falas për fëmijën e dytë, nëse në kopsht është i përfshirë njëkohësisht edhe vëllai ose motra më e madhe. Gjithashtu, kopshti është falas për fëmijën e tretë dhe çdo fëmijë tjetër pas tij, pavarësisht nëse në kopsht janë të përfshirë vëllezërit ose motrat e tij.

PËRGATITJET PËR HYRJE NË KOPSHT

- Takim i përbashkët për prindërit e fëmijëve të rinj në muajin qershor.
- Bisedë individuale me edukatorët, ku merrni pjesë prindërit së bashku me fëmijën, rreth një javë para përfshirjes së fëmijës. Në takim do të flisni për zakonet e fëmijës, si fle më lehtë, si qetësohet, me çfarë i pëlqen më shumë të luajë, si ushqehet, për përvojat e mëparshme me kujdesin, veçoritë e mundshme shëndetësore dhe trajtimet te specialistë të ndryshëm.


PËRSHTATJA GRADUALE NË KOPSHT

Është krejtësisht normale që fëmija, kur hyn në kopsht, të qajë më shumë, të jetë më i ndjeshëm dhe më i lodhur, të ketë vështirësi me gjumin, ushqimin etj. Kjo zakonisht zgjat disa ditë dhe te shumica e fëmijëve kalon shpejt.

Prindërve u këshillohet që për periudhën e përshtatjes të marrin **disa ditë të lira** dhe të jenë të pranishëm në kopsht së bashku me fëmijën. Për orën e ardhjes dhe kohën që do të kaloni në kopsht do të merreni vesh me edukatoren. Në ditët e para fëmija mund të sjellë me vete lodrën e preferuar, e cila do t'i kujtojë shtëpinë.

GJËRAT E NEVOJSHME TË FËMIJËS NË KOPSHT

- Fëmijët duhet të kenë në kopsht **rroba dhe këpucë rezervë, pantofla të nënshkruara, qese për rroba të ndotura, sasi të mjaftueshme pelenash dhe peceta të lagura**.
- Në periudhën fillestare rekomandohet që fëmijët të kenë me vete edhe **lodrën e preferuar ose sendin qetësues**.



BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT

Prindërit mund të marrin informacione për fëmijën dhe kopshtin përmes:

- **shkëmbimit të përditshëm të informacioneve** ndërmjet edukatorëve dhe prindërve,
- **orëve të bisedës**, që zhvillohen një herë në muaj, (pritet që prindërit të marrin pjesë të paktën një herë në vit, ose kur edukatorët ju ftojnë për biseda individuale),
- **mbledhjeve të prindërve** të grupeve, që zhvillohen dy herë në vit, (pritet që prindërit të marrin pjesë në të dy mbledhjet),
- **takimeve të përbashkëta në nivel grupi dhe njësie**,
- **ligjëratave për prindër**.

Informacionet e rëndësishme për prindërit janë të publikuara në tabelat e shpalljeve në dyert e dhomave të lojës dhe në **e-igralnice** (*e-vendi i lojrave*). Secili grup ka e-igralnicën e vet, për të cilën prindërit krijojnë llogari përdoruesi dhe hyjnë me fjalëkalimin që e përcakton edukatori/ja i/e grupit. Udhëzimet më të hollësishme për përdorimin e **e-igralnice** janë në:

www.vrtec-skofjaloka.si/za-starse/e-igralnice.

LAJMËRIMI I MUNGESËS SË FËMIJËS NË KOPSHT

Në rast se prindërit nuk e sjellin fëmijën në kopsht, mungesën mund ta njoftojnë më së voni deri në orën 7 të mëngjesit përmes aplikacionit **WEB VRTEC**. Shënoni ditët kur fëmija nuk do të jetë në kopsht dhe shkruani arsyen, për shembull; sëmundje. Qasjen në aplikacion do ta merrni me postë elektronike.

PËRFSHIRJA NË RAST SËMUNDJEJE

Prindërit **NUK** duhet ta sjellin fëmijën në kopsht nëse:

- në 48 orët e fundit ka pasur temperaturë të lartë, diarre ose ka vjellë;
- ka skuqje ose puçrra në lëkurë;
- ka morra ose zgjebe.

Për sëmundje të tjera ndiqen udhëzimet e mjekut. Gjatë kthimit të fëmijës në kopsht pas sëmundjes duhet marrë parasysh edhe gjendja e përgjithshme e fëmijës, mirëqenia dhe aftësia që të ushqehet, flejë dhe luajë normalisht.

Për shfaqjen e sëmundjeve dhe masat për parandalimin e tyre, kopshtet i njoftojnë prindërit përmes njoftimeve në tabelat e shpalljeve. **Në rast se fëmija sëmurët në kopsht, prindërit njoftohen menjëherë dhe pritët që ata të vijnë ta marrin fëmijën e sëmurë sa më shpejt.** Në këtë mënyrë mbrohet shëndeti i fëmijëve të tjerë në kopsht, ndërsa fëmijës së sëmurë i mundësohet kujdesi i duhur në shtëpi.

TRAJTIMI I HERSHËM

Nëse vërehen vështirësi në zhvillimin e fëmijës, ai merr ndihmë shtesë profesionale në kopsht. Në këtë proces bashkëpunojnë prindërit, kopshti dhe shëndetësia. Për pyetje shtesë mund t'i drejtoheni shërbimit këshillues të kopshtit.

SHKOLLA FILLORE

Në Slloveni arsimi fillor për nxënësit nga mosha 6 deri në 15 vjeç është i detyrueshëm. Shkolla fillore zgjat 9 vjet dhe është falas. Në klasën e parë të shkollës fillore regjistrimi fëmijët që në vitin kalendarik kur fillojnë shkollën mbushin 6 vjeç. Regjistrimi në shkollë fillore bëhet në muajin shkurt. Më shumë për regjistrimin dhe programin, edhe për fëmijët tuaj që kanë qenë tashmë të përfshirë në arsimin fillor, do t'ju tregojnë në shkollën fillore më të afërt. Informacionet për pagesën e ulur të shujtave dhe drekave i merrni në Qendrën për punë sociale.

Osnovna šola Škofja Loka-Mesto

Shkolla Fillore Škofja Loka-Mesto

Šolska ulica 1, 4220 Škofja Loka

www.ossklm.si

info@ossklm.si

+386 4 506 00 11

Osnovna šola Ivana Groharja

Shkolla Fillore Ivana Groharja

Podlubnik 1, 4220 Škofja Loka

www.groharca.si

info@os-igroharja.si

+386 4 506 11 13

Osnovna šola Cvetka Golarja

Shkolla Fillore Cvetka Golarja

Frankovo naselje 51, 4220 Škofja Loka

www.oscg.si

info.c-golar@guest.arnes.si

+386 4 513 04 00

Osnovna šola Jela Janežiča

Shkolla Fillore Jela Janežiča

Podlubnik 1, 4220 Škofja Loka

www.os-jela-janezica.si

jela.janezica@os-jela-janezica.si

+386 4 506 14 11

Shkolla Fillore Jela Janežiča është shkollë fillore me program të përshtatur dhe zbaton dy programe:

- **Programi i përshtatur i shkollës fillore me standard më të ulët arsimor – NIS;**
- **Programi i veçantë i edukimit dhe arsimit – PP.**

Punonjësit e Shkollës Fillore Jela Janežiča në shkolla dhe kopshte të tjera ofrojnë **ndihmë shtesë profesionale – DSP**.

SHKOLLA E MESME

Arsimi i mesëm zhvillohet në gjimnaze, shkolla profesionale ose shkolla teknike dhe zgjat 3 ose 4 vjet. Konkursi për regjistrim publikohet çdo vit në Shkurt. Në atë kohë në shkollat e mesme mbahen edhe ditët informative, ku mësoni gjithçka për programet e shkollës. Regjistrimi në shkollat e mesme bëhet në Mars. Edhe nxënësit e shkollave të mesme mund të kenë të drejtë për ulje të pagesës së shujtës shkollë.

Šolski center Škofja Loka

Qendra Shkollore Škofja Loka

Podlubnik 1b, 4220 Škofja Loka

www.scsli.si

info@scsli.si

+386 4 50 62 300

Gimnazija Škofja Loka

Gjimnazi Škofja Loka

Podlubnik 1b, 4220 Škofja Loka

www.gimnazija-skofjaloka.si

info@gimnazija-skofjaloka.si

+386 4 51 83 330

ARSIMI PËR TË RRITUR

Jeni i rritur dhe dëshironi të përfundoni arsimin? Dëshironi të arsimoheni më tej? Ju ofrohen shumë mundësi për përfundimin dhe fitimin e arsimit formal, si edhe për përfshirje në programe joformale falas në formë punëtorish dhe ligjëratash për zhvillim personal, forcim të aftësive bazë, përfshirje më të lehtë në rrethin lokal etj. Keni aftësi dhe njohuri për një profesion të caktuar, por nuk keni vërtetime formale? Në këtë rast mund të përfshiheni në programin NPK, kualifikimi profesional kombëtar, dhe kështu të arrini më shpejt profesionin e dëshiruar. Paraqituni në Universitetin Popullor Škofja Loka, ku do t'ju këshillojnë dhe ndihmojnë. Disa programe arsimimi për të rritur janë edhe falas.

Oferta për arsimimin e të rriturve ofrohet edhe nga Qendra e Republikës së Sllovenisë për Arsim Profesional, www.cpi.si/o-cpi/kje-smo) dhe Qendra për Trajnim Biznesi, www.cpu.si.

Kurset e gjuhës sllovene

Jeta në një rreth të ri sigurisht do t'ju lehtësohet nga njohja e gjuhës sllovene. Për shtetasit e vendeve të treta, të gjitha vendet përveç anëtarëve të BE-së, EEA-së dhe Zvicrës, është në dispozicion kursi falas i gjuhës sllovene, i organizuar në kuadër të programit ZIP – Integrimi fillestar i të huajve. Ai zbatohet në të gjithë Slloveninë. Kontaktet e organizatorëve të kurseve janë në dispozicion në linkun e mëposhtëm. Lista e plotë aktuale është publikuar këtu:

www.infotujci.si/vkljucevanje-v-slovensko-druzbo/brezplacni-tecaji-slovenskega-jezika.

Kursin mund ta ndiqni nëse keni leje të vlefshme qëndrimi, nuk shkolloheni ose nuk e keni përfunduar shkollimin në Slloveni dhe ende nuk e keni kaluar me sukses provimin e njohjes së gjuhës sllovene në nivel bazë. Kursi zgjat deri në 180 orë. Kusht për pjesëmarrje është vërtetimi i Njesisë administrative, Vërtetimi për plotësimin e kushteve për pjesëmarrje në programin e unifikuar, për të cilin duhet të paguani 22,60 euro. Për të hyrë në provim kërkohet të paktën 80% pjesëmarrje në ligjëratat, ndërsa dhënia e provimit është falas. Universiteti Popullor Škofja Loka është edhe qendër e autorizuar provimesh, e cila në bashkëpunim me Qendrën për sllovenishten si gjuhë e dytë dhe e huaj, Departamenti i Sllovenistikës, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Ljubljanes, organizon provime të njohjes së sllovenishtes në nivel bazë sipas programit publikisht të vlefshëm arsimor "Sllovenishtja si gjuhë e dytë dhe e huaj".

Ljudska univerza Škofja Loka
Universiteti Popullor Škofja Loka

Podlubnik 1a, 4220 Škofja Loka

www.lu-skofjaloka.si

info@lu-skofjaloka.si

+386 4 506 13 00

Kurset joformale të gjuhës sllovene

Kurset joformale të gjuhës sllovene ju mundësojnë përgatitjen për provimin në nivel mbijetese, të cilin duhet ta kryeni për vazhdimin e lejes së qëndrimit të përkohshëm për shkak të bashkimit familjar. Para regjistrimit në kurs duhet të merrni vërtetim në Njësinë administrative, shih kapitullin për shërbimet administrative.

Më shumë për kurset ZIP dhe programin joformal të mësimin të gjuhës sllovene në nivel mbijetese:

www.infotujci.si/vkljucevanje-v-slovensko-druzbo/brezplacni-tecaji-slovenskega-jezika.

PUNËSIMI

Kërkesa për leje pune është e përfshirë në kërkesën për leje unike, e cila të huajve nga vendet e treta u mundëson hyrje, qëndrim dhe punësim ose kryerje pune në Slloveni. Kërkesën për leje unike e dorëzoni në Njësinë administrative, nëse tashmë jeni në Slloveni ose në përfaqësinë diplomatike-konsullore të Sllovenisë në vendin tuaj. Para dorëzimit të kërkesës njoftoni punëdhënësin, sepse në ditën e dorëzimit të kërkesës ai duhet t'i ketë të shlyera të gjitha detyrimet tatimore.

Procedurën për lëshimin e lejes unike për qëndrim dhe punë e udhëheq Njësia administrative, ndërsa Enti për Punësim jep pëlqimin për lejen unike për qëndrim dhe punë, nëse i plotësoni të gjitha kushtet. Kushtet ndryshojnë sipas llojit të punës.

Hollësitë do t'ju shpjegojnë në Entin për Punësim dhe janë publikuar edhe këtu: www.ess.gov.si/delodajalci/zaposlovanje-tujcev-iz-tretjih-drzav/enotno-dovoljenje.

Për punësimin e shtetasve të Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë, si dhe për punët sezonale në bujqësi/pylltari dhe turizëm/gastronomi që janë më të shkurtra se 90 ditë, lejet e punës i lëshon Enti për Punësim.

Vetëpunësimi: Të huajt mund të vetëpunësohen pas një viti qëndrimi të pandërprerë dhe të ligjshëm në Slloveni ose pas regjistrimit në regjistrin e biznesit. Pëlqimi i Entit për Punësim në këtë rast nuk është i nevojshëm.

Për të drejtat dhe detyrimet tuaja dhe të punëdhënësit mund të informoheni në Këshillimorën e Punëtorëve në numrin falas 080 14 34 ose në www.delavskasvetovalnica.si.

Pika informative për të huajt:

www.ess.gov.si/iskalci-zaposlitve/zaposlitev-tujih-drzavljanov/infotocka-za-tujce.

Zavod za zaposlovanje, Urad za delo Škofja Loka
Enti për Punësim, Zyra e punës Škofja Loka
Stara cesta 2, 4220 Škofja Loka
gpzrszkranj@ess.gov.si
+386 4 777 52 70

SPORTI, KULTURA DHE JETA SHOQËRORE

Për mirëqenien në rrethin e ri kontribuojnë shumë edhe aktivitetet e kohës së lirë, prandaj ju ftojmë të bashkoheni me cilindo aktivitet në vendin tuaj dhe kështu të njiheni më mirë me vendasit. Shumica janë falas, organizatorët janë gjithmonë të lumtur për pjesëmarrës të rinj, ndërsa për hollësi pyesni organizatën përkatëse.

Informacionet për ngjarjet në Škofja Loka dhe rrethinë i gjeni në faqen e Turizmit Škofja Loka: www.visitskofjaloka.si/si/dogodki.

Për aktivitetet sportive kujdesen shoqatat sportive. Kontrolloni në adresat më poshtë dhe në internet se çfarë ekziston në afërsinë tuaj. Me siguri mund t'i bashkoheni ekipit lokal të futbollit, basketbollit, hendbollit, volejbollit ose me shoqatën alpinistike të vizitoni majat e afërta dhe kështu ta njihni edhe më mirë vendin tuaj të ri.

Enti për Sport Škofja Loka: www.zsport-skloka.si

Lidhja Sportive Škofja Loka – shoqatat: www.zsport-skloka.si/drustva

Nëse më shumë se sporti ju intereson **kultura**, gjatë shetitjes në qytet mund të vizitoni ndonjë muze ose galeri, të shihni një ekspozitë ose t'i bashkoheni një shoqate kulturore lokale dhe t'i njihni atraksionet së bashku me anëtarët e tjerë.

Muzeu i Lokës Škofja Loka: www.loski-muzej.si

Sokolski dom: www.sokolskidom.si

Kino Sora: www.kinosora.si

Qendra e Zejtarišë Škofja Loka: www.centerduo.eu

Qendrat rinore ofrojnë hapësirë për takime, shoqërim dhe aktivitete për fëmijë dhe të rinj. Organizohen aktivitete shoqërore dhe kulturore, aktivitete sportive dhe aktivitete joformale arsimore, si punëtori, kurse, ligjërata dhe tryeza të rrumbullakëta.

Dnevni center za otroke in mladostnike - DC OM
Qendra ditore për fëmijë dhe të rinj – DC OM
Partizanska 1d, 4220 Škofja Loka
dcom.mesto@gmail.com
+386 30 226 508

Dnevni center za mlade - DCM Podlubnik
Qendra ditore për të rinj – DCM Podlubnik
Podlubnik 139, 4220 Škofja Loka
dcm.podlubnik@gmail.com
+386 51 363 107

Društvo prijateljev mladine Škofja Loka
Shoqata e Miqve të Rinisë
(aktivitete gjate pushimeve për fëmijë)
www.dpm-skofjaloka.si
dpm.skofjaloka@gmail.com
+386 69 434 920

Mladinski dnevni center - MDC Blok
Qendra ditore rinore – MDC Blok
Frankovo naselje 68, 4220 Škofja Loka
blok@familija.eu
+386 40 326 165

Një thesar i vërtetë informacioni për ngjarjet aktuale në rrethin tuaj janë edhe **bibliotekat**, prandaj vizitoni bibliotekën më të afërt dhe pyesni për ngjarjet më të reja. Në biblioteka ka edhe shumë ngjarje për fëmijët tuaj të vegjël dhe nxënësit.

Knjižnica Ivana Tavčarja Škofja Loka
Biblioteka Ivana Tavčarja Škofja Loka

Šolska ulica 6, 4220 Škofja Loka
www.knjiznica-skofjaloka.si
info@knjiznica-skofjaloka.si
+386 51 672 367

Aktivitete krijuese dhe arsimore për të rritur

Zavod Tri organizon aktivitete të ndryshme krijuese dhe arsimore për të rritur, të cilat nxisin lidhjen ndërkulturore dhe mësimin e gjuhës sllovene në komunitet. Në kuadër të entit funksionon edhe komuniteti tekstil »Breja preja«, i cili përfaqëson një hapësirë krijuese për shoqërim ndërkulturor dhe mësim të gjuhës sllovene në praktikë.

Zavod Tri

Kapucinski trg 8, 4220 Škofja Loka
www.zavod-tri.org
info@zavod-tri.org
+386 40 528 387

Nëse ndonjëherë gjendeni në një situatë ku është e rrezikuar jeta juaj ose jeta e dikujt tjetër, telefononi në numrin 112: urgjenca mjekësore, zjarrfikësit, policia. Nëse keni qenë viktimë ose dëshmitar i një veprë penale ose dyshoni për një vepër penale, telefononi policinë në numrin 113. Policinë mund ta telefononi edhe në mënyrë anonime dhe falas në numrin 080 1200.



REPUBLIKA SLOVENIJA
MINISTRSTVO ZA JAVNO UPRAVO



Občina Škofja Loka

Broshurën informative "Škofja Loka, vendi im i ri" e bashkë-botojnë Komuna e Škofja Llokës dhe Zavod Tri në kuadër të programit »Qendra rajonale e organizatave joqeveritare të Gorenjskës«.

Škofja Loka, maj 2026